

V E N D I M
Nr.1, datë 10.1.1994

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar, i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani,	Zv/Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""
Veli Budo,	Anëtar i ""
Franc Jakova	Anëtar i ""
Thimjo Kondi,	Anëtar i ""
Ylvi Myrtja,	Anëtar i ""
Natasha Sheshi,	Anëtar i ""

me sekretare Drita Filto më datën 20.12.1993 dhe 10.1.1994, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15/2 Akti, që i përket:

KËRKUESE: GJYKATA E RRETHIT TIRANE

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE, i përfaqësuar nga Eqerem Vaqarri, Mirela Selita dhe Lorta Çollaku.

2. MINISTRIA E DREJTËSISË, e përfaqësuar nga Artan Hoxha

O B J E K T I

Pajtueshmëria me nenet 155 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të pikës 1 "c" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Parlamenti me ligjin nr.7663, datë 20.1.1993, ka përcaktuar statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, duke vendosur kriteret për fitimin e këtij statusi dhe përfitimet morale e materiale që rrjedhin prej tij. Në nenin 10 të këtij ligji përcaktohet shprehimisht se "Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Këshilli i Ministrave".

Këshilli i Ministrave në zbatim të ligjit të lartpërmendur për statusin e invalidit të luftës, ka marrë vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të titulluar "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", në pikën 1 "c" të të cilit parashikohet se "kur nuk ka dokumente zyrtare, plagosja a gjymtimi në luftën kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar vërtetohet në rrugë gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi".

Në bazë të nenit 155 të Kodit të Procedurës Civile dhe të dispozitës së sipërcituar të vendimit nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave, shtetasi Pandi Lara i është drejtuar gjykatës së rrethit Tiranë me kërkesën për vërtetimin e faktit të ngrirjes së këmbëve gjatë pjesëmarrjes në luftë në dimrin e vitit 1943-1944.

Gjykata e rrethit të Tiranës, me vendimin datë 29.11.1993, duke u bazuar në nenin 8 të ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe ka kërkuar prej Gjykatës Kushtetuese që të shprehet për pajtueshmërinë ose jo të pikës 1 "c" të vendimit nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave me nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë çmon se pika 1 "c" e vendimit nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave bie në kundërshtim me nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile.

Në këtë dispozitë përcaktohen në mënyrë taksative rastet e vërtetimit në rrugë gjyqësore të fakteve me karakter juridik në mungesë të dokumenteve zyrtare. Kjo do të thotë se, veç ligjvënësit asnjë organ tjetër nuk mund të përcaktojë e të shtojë raste të tjera të ngjashme. Në të kundërt, dispozitat me karakter indikativ lënë vend për interpretim të zgjeruar në procesin e zbatimit të tyre,

duke përfshirë këtu edhe raste të tjera që nxjerr jeta, të cilat nuk mund t'i parashikonte ligjvënësi e që, gjithësesi, i referohen objektit të përgjithshëm të rregullimit juridik në normën përkatëse.

Ligjvënësi, po ta kish çmuar të nevojshme, në ligjin për statusin e invalidit kishte mundësi të shtonte në numrin e fakteve që vërtetohen gjyqësisht sipas nenit 155 e vijues të Kodit të Procedurës Civile edhe faktin e gjymtimit a të plagosjes në luftën kundër pushtuesve. Por, atë që nuk e ka bërë ligjvënësi nuk mund ta bëjë ekzekutivi. Për më tepër, neni 10 i ligjit për statusin e invalidëve të luftës ngarkon Këshillin e Ministrave me zbatimin e ligjit, por nuk bën ndonjë delegim legjislativ. Për rrjedhojë, Këshillit të Ministrave nuk i lind e drejta të miratojë dispozita që do të kapërcenin përmbajtjen e ligjeve ekzistuese, siç është në rastin konkret pika 1 "c" e vendimit nr.326, datë 21.6.1993. Sipas nenit 36, pika 1 të ligjit Kushtetues "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Këshilli i Ministrave ka të drejtë të nxjerrë vendime, urdhëresa e udhëzime në bazë të kushtetutës e të ligjeve dhe për zbatimin e tyre, por miratimi i rregullave të përgjithshme e të veçanta duhet të bëhet kurdoherë brenda kuadrit të dispozitave ligjore ekzistuese e pa dalë jashtë natyrës së tij ekzekutive urdhërdhënëse.

Pretendimi i përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë, sipas të cilit pika 1 "c" e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 nuk i referohet procedurës së veçantë të vërtetimit të fakteve me karakter juridik (gracioze), por procedurës së zakonshme gjyqësore me palë kundërshtare (kontencioze), nuk është i bazuar. Interpretimi në tërësi i pikës 1 të vendimit në fjalë (në shkronjat "a" dhe "b" të të cilit parashikohen dokumentat që duhet të paraqiten për përfitimin e pensionit të invalidit dhe institucionet përkatëse ku duhet të kërkohen këto dokumente), të çon në përfundimin se në këtë akt nënligjor parashikohet një rast i veçantë i vërtetimit të faktit juridik. Në të kundërt Këshilli i Ministrave do të parashikonte organet apo komisionet e veçanta kompetente për vërtetimin e faktit në rrugë administrative, në rastet kur mungojnë dokumentet zyrtare që përbëjnë provë të plotë dhe, si rrjedhojë e natyrshme, gjykimi me palë kundërshtare do të kish vend sa herë do të lindnin kundërshtime ndaj vendimit të organit apo komisionit përkatës, duke u legjitimuar për ngritjen e padisë, sipas rastit, personi fizik i interesuar apo përfaqësuesit e shtetit.

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese çmon se pika 1 "c" e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 është e kundërligjshme dhe, si e tillë mbetet pa fuqi.

Meqë marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi duhet t'i dërgohet Këshillit të Ministrave për të marrë masat përkatëse.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 3 dhe 26 paragrafi i fundit, i ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992,

V E N D O S I:

Të shpallë të kundërligjshme dhe të lërë pa fuqi pikën 1 "c" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e komunikimit Këshillit të Ministrave dhe Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Tiranë më 10.1.1994